

SHMP "Abdyl Ramaj" në Shirokë-Suharekë.

Nr. Protokolli: 359/2022

Datë: 08.04.2022

Në bazë të Nenit 11 të Udhëzimit Administrativ, -Aktivitetet jashtëshkollore Nr. 02/2016,
SHMP "Abdyl Ramaj" në Shirokë -Suharekë bën:

FTESË PËR OFERTË NR. 01/2022

Pas vendimit të marrë nga Këshilli Drejtues i Shkollës, u bëjmë thirrje Agjencie turistike të marrin pjesë për Ofertë për Projektin Shkollor "Ekskursioni i maturantëve, Prill/2022" të SHMP "Abdyl Ramaj" në Shirokë, Komuna Suharekë.

- Ekskursioni planifikohet të zhvillohet në Republikën e Shqipërisë ndërmjet datave 25.04.2022 dhe 30.04.2022. Kohëzgjatja e ekskursionit është 4 bujtje/5 ditë, me pansion të plotë;
- Në ekskursion do të marrin pjesë 153 nxënës;
- Në ofertë të parashihet çmimi i akomodimit, ushqimit (mëngjesi+dreka+darka), transporti dhe shpenzimet e ndryshme që paraqiten me rastin e vizitave në muze dhe ambiente tjera kulturo historike të përcaktuara nga Këshilli Drejtues i Shkollës.

Agjensionet turistike që marrin pjesë në ftesën për ofertë të SHMP "Abdyl Ramaj" Shirokë, Komuna Suharekë për Projektin shkollor "Ekskursioni i maturantëve Prill / 2022" duhet të i plotësojnë këto parakushte:

1. Certifikata e regjistrimit të Biznesit, me faqet për aktivitetet e lejuara, me te drejte transporti te udhëtimeve te organizuara jashtë shteti;
2. Vërtetimi nga ATK, që kompania ofertuese nuk ka obligime të pa shlyera;
3. Vërtetimi i pagesës së taksave komunale për biznes -fotokopje;
4. Licenca "D" për drejtuesit e autobusëve, Fotokopje e noterizuar;
5. Certifikata e mjekut -CPC për shëndetin fizik dhe mendor të drejtuesve të autobusëve të angazhuar në ekskursion;
6. Të ketë kontrollin teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore, të dëshmuar përmes dëshmime, fotokopje për të gjithë autobusët që do të përdoren në ekskursion. Autobusët të jenë komfor dhe me klimë.
7. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e ekskursionit;
8. OE duhet të ketë kapacitete të zëvendësimit të autobusëve në rast nevojë për kohë optimale;

9. Agjensioni të sigurojë përkujdesjes mjekësore, për pjesëmarrësit në ekskursion gjatë tërë kohëzgjatjes së tij. Të ofrohet leja e punës së mjekut, marrëveshje kontraktuale me mjekun për tërë periudhën e kohëzgjatjes së ekskursionit (fotokopje);
10. OE të ofrojë dëshmi me shkrim për akomodim në hotel për të gjithë pjesëmarrësit në ekskursion në plotësim të kërkesave të itinerarit të ekskursionit, të vërtetuar nga pronari i hotelit për akomodim;
11. Licenca e punës nga agjensioni i akreditimit të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (E vërtetuar nga pronari i hotelit-restorantit);
12. Të ofrojë licencën e agjensionit të akreditimeve për sallën ku do të realizohen aktivitetet e lira të nxënësve (Zërim, klimatizim);
13. Hoteli ku bëhet akomodimit i nxënësve duhet të ketë shërbimin e sigurimit fizik profesional;
14. Dokumentet jashtë afatit të paraparë për ofertë nuk pranohen;
15. Dokumentet jo të kompletuara nuk shqyrtohen;

Dorëzimi i ofertave bëhet deri më datë 20.04.2022 në ora 14:00 në zyrën pritëse të Komunës për DKA për SHMP "Abdyl Ramaj" në Shirokë;

Hapja e ofertave bëhet me datë 20.04.2022 në ora 15:00 në SHMP "Abdyl Ramaj" në Shirokë;

Formulari i paraqitjes së Ofertës dhe Itinerari i ekskursionit i hartuar nga shkolla merret në SHMP "Abdyl Ramaj" në Shirokë, nga data 20.04.2022.

Suharekë, më 08.04.2022



Drejtori i shkollës: Destan Berisha

Destan Berisha